

 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MIEDITIT, PLANIFIKIMIT NAFËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. jedinica Org. Unit Nr. i Faqeve Nr. Stranica No. Pages	DPHNB / 1
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Data: Datum: Date:	8652/24 31.12.24 Na 1
PRISHTINË / A	

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 10 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3 dhe Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafi 3.1, duke u bazuar në Nenin 34 paragrafin 2, Nenin 37 paragrafin 7 dhe Nenin 38 paragrafin 3 të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr. 1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

RREGULLORE PËR PROCEDURËN DISIPLINORE NDAJ ANËTARËVE TË ODËS

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurës disiplinore, përfshirë masat disiplinore, ndaj anëtarëve të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda), në përputhje me Ligjin.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën dhe organet e saj si dhe të gjithë inxhinierët e licencuar në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Zbatimi i Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative

Për çështje të cilat nuk janë rregulluar shprehimisht me këtë Rregullore zbatohet Ligji në fuqi i Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Neni 4 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
2. Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

KAPITULLI II

PËRGJEGJËSIA DHE SHKELJET DISIPLINORE

Neni 5

Përgjegjësia disiplinore

1. Inxhinieri i licencuar mban përgjegjësi disiplinore nëse me veprimin apo mosveprimin e tij në ushtrimin e veprimtarisë profesionale bën shkelje disiplinore.
2. Përgjegjësia për vepër penale apo kundërvajtje nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të inxhinierit të licencuar.

Neni 6

Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet disiplinore të inxhinierit të licencuar përcaktohen me Ligjin në fuqi dhe ndahen në shkelje të rënda disiplinore dhe shkelje të lehta disiplinore.
2. Kjo Rregullore dhe Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale përcaktojnë veprimet apo mosveprimet e inxhinierit të licencuar që kategorizohet në një nga shkeljet disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni.

Neni 7

Shkeljet e rënda disiplinore

1. Shkelje e rëndë disiplinore e inxhinierit të licencuar është:
 - 1.1. Shkelja e rëndë e parimeve dhe rregullave të Odës të përcaktuara me Ligjin në fuqi, Statutin apo dhe aktet nënligjore të Odës;
 - 1.2. Neglizhenca e rëndë në kryerjen e punëve profesionale në atë mënyrë që paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurinë publike ose mjedisin;
 - 1.3. Kryerja e punëve në ndërtim pa pëlqimet dhe lejet e kërkuara me legjislacionin në fuqi;
 - 1.4. Shkelja e reputacionit të profesionit që e ushtron, e përcaktuar me Kodin e Etikës të nxjerrë nga Oda e Inxhinierëve, dhe
 - 1.5. Neglizhenca apo paafërsia për kryerjen e përgjegjësi si anëtar i cilitdo organ të Odës.
2. Shkeljet nga paragrafi 1, nën-paragrafët 1.4 dhe 1.5 konsiderohen shkelje të rënda vetëm nëse kanë peshë të madhe në kuptim të rëndësisë së pronës apo interesit publik të rrezikuar, natyrës

së detyrimit të shkelur, lartësisë së dëmit të shkaktuar ose pasojave tjera, dhe për kategorizimin e tyre si shkelje e rëndë merren parasysh rrethanat e kryerjes së veprimit apo mosveprimit.

Neni 8

Shkeljet e lehta disiplinore

Shkelje e lehtë disiplinore e inxhinierit të licencuar është çdo shkelje tjetër disiplinore e përcaktuar me Ligjin në fuqi sa i përket detyrimeve të inxhinierit të licencuar, reputacionit të profesionit dhe e Kodit të Etikës që është e rëndësisë më të vogël dhe nuk konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore.

KAPITULLI III

ZHVILLIMI I PROCEDURËS DISIPLINORE

Neni 9

Njoftimi për shkeljen disiplinore të inxhinierit

1. Çdo person fizik ose juridik mund të njoftoj Odën për çfarëdo pretendimi për parregullsi në punën e inxhinierit të licencuar.
2. Njoftimi paraqitet me shkrim tek Oda dhe përmban të dhënat në vijim:
 - 2.1. identitetin e personit fizik ose juridik i cili e paraqet njoftimin;
 - 2.2. Emrin dhe Mbiemrin e inxhinierit të licencuar për të cilin pretendohet se ka shkaktuar shkelje disiplinore, dhe
 - 2.3. një përshkrim konciz të fakteve mbi të cilat ngritet pretendimi për shkelje disiplinore.
3. Administrata e Odës evidenton njoftimin e pranuar dhe i lëshon një vërtetim palës që dëshmon pranimin, datën, qëllimin e ankesës dhe listën e dokumenteve të bashkëngjitura, nëse ka të tilla.
4. Njoftimi i pranuar i dërgohet për shqyrtim Bordit Drejtues të Odës (në tekstin e mëtejme: Bordi) dhe për të njoftohet inxhinieri i licencuar për të cilin pretendohet shkelja.
5. Në rast se njoftimi nga ky Nen i dërgohet ndonjë organi tjetër të Odës, atëherë ky organ pa vonesë e përcjell njoftimin tek Bordi.

Neni 10
Shqyrtimi i njoftimit nga Bordi

1. Bordi shqyrton njoftimin e pranuar dhe bën vlerësimin fillestar për shkeljen disiplinore të pretenduar, në afat prej tridhjetë (30) ditë nga pranimi i njoftimit.
2. Vlerësimi fillestar përfshin vërtetimin e dyshimit të bazuar për ekzistimin e shkeljes disiplinore të pretenduar.
3. Gjatë shqyrtimit, Bordi ka të drejtë të dëgjojë palën dhe inxhinierin ndaj të cilit është paraqitur ankesa.
4. Bordi ka të drejtë gjithashtu të mbledh fakte dhe prova lidhur me shkeljen disiplinore të pretenduar.
5. Pas vlerësimit fillestar, Bordi:
 - 5.1. ndërpret procedurën nëse vlerëson që faktet e ngritura nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje disiplinore, ato janë të pabazuara, apo shkelja disiplinore është parashkruar, ose
 - 5.2. në të kundërtën, propozon fillimin e procedurës disiplinore tek Komisioni Disiplinor.
6. Bordi mbështetet nga Administrata e Odës për zbatimin e këtij Neni.

Neni 11
Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore

1. Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore mund ta paraqes:
 - 1.1. Bordi, apo
 - 1.2. Një e treta (1/3) e anëtarëve të Odës;
2. Propozimi nga paragrafi 1 i drejtohet Komisionit Disiplinor përmes Administratës së Odës.
3. Propozimi paraqitet me shkrim dhe përmban informatat themelore në vijim:
 - 3.1. Emrin dhe Mbiemrin e inxhinierit të licencuar;
 - 3.2. Datën e paraqitjes së propozimit dhe emrin e organit kujt i drejtohet;

- 3.3. Shkeljen disiplinore për të cilën supozohet se e ka shkaktuar inxhinieri i licencuar dhe datën kur është bërë shkelja;
 - 3.4. Faktet dhe provat në të cilat bazohet propozimi, dhe
 - 3.5. Emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e paraqitësit të propozimit, përkatësisht personit të autorizuar për paraqitjen e propozimit.
4. Administrata e Odës e regjistron propozimin nga ky Nen dhe brenda pesë (5) ditësh e dërgon dosjen në tërësi tek Komisioni Disiplinor.

Neni 12

Shqyrtimi i pranueshmërisë së Propozimit për fillimin e procedurës disiplinore

1. Pas pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor shqyrton brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pranueshmërinë e propozimit, dhe nxjerr vendim mbi propozimin.
2. Komisioni Disiplinor me vendim:
 - 2.1. Hedh poshtë propozimin si jo të plotë, nëse propozimi nuk i përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara në paragrafin 3 të Nenit 11, pasi të ketë kërkuar paraprakisht plotësimin nga propozuesi;
 - 2.2. Hedh poshtë propozimin si të vonshëm nëse shkelja e pretenduar është parashkruar;
 - 2.3. Hedh poshtë propozimin si të papranueshëm nëse nuk është paraqitur nga ana e personave të autorizuar për fillimin e procedurës disiplinore;
 - 2.4. Pranon propozimin dhe e fillon procedurën disiplinore.
3. Me vendimin e Komisionit Disiplinor nga paragrafi 2 njoftohet inxhinieri i licencuar dhe parashtruesi i Propozimit.

Neni 13

Shqyrtimi administrativ nga Komisioni

1. Gjatë procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor ka të drejtë të mbledh fakte dhe prova shtesë lidhur me shkeljen disiplinore për të cilën ka filluar procedura, si dhe të verifikoj faktet dhe provat e paraqitura me propozimin nga Neni 11.
2. Me njoftimin për fillimin e procedurës nga paragrafi 3 i Nenit 10, Komisioni Disiplinor i cakton një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë inxhinierit të licencuar ndaj të cilit ka filluar

procedura, për t'u deklaruar me shkrim tek Komisioni lidhur me përgjegjësinë e tij/saj si dhe për të paraqitur fakte apo argumente mbështetëse.

3. Komisioni Disiplinor mund të dëgjoj/intervistoj inxhinierin e licencuar ndaj të cilit ka filluar procedura dhe çdo palë tjetër të cilën e konsideron relevante për marrjen apo sqarimin e fakteve dhe provave lidhur me shkeljen disiplinore. Në rast të kërkesës së inxhinierit, Komisioni është i detyruar të lejoj inxhinierin të shpreh pikëpamjet e tij në mënyrë verbale para Komisionit.

4. Inxhinieri i licencuar ndaj të cilit ka filluar procedura disiplinore është i detyruar të bashkëpunoj me Komisionin dhe të paraqes të gjitha informatat, dokumentet dhe të dhënat tjera nga veprimtaria profesionale e inxhinierit, për të cilat Komisioni vlerëson se janë relevante për shqyrtimin administrativ lidhur me shkeljen disiplinore.

Neni 14

Vendimi i Komisionit për përgjegjësinë disiplinore të inxhinierit

1. Komisioni merr vendim për përgjegjësinë disiplinore të inxhinierit të licencuar në afat prej dyzetepesë (45) ditë nga dita e vendimit të fillimit të procedurës disiplinore.

2. Në rast se nga faktet dhe provat e shqyrtuara vërtetohet përgjegjësia disiplinore e inxhinierit, Komisioni merr vendim të arsyetuar me të cilin inxhinierin e gjen përgjegjës për shkeljen disiplinore të caktuar dhe shqipton një apo më shumë nga masat disiplinore.

3. Shkelja disiplinore e supozuar nga propozuesi i procedurës disiplinore mund të rikualifikohet ndryshe nga Komisioni Disiplinor po që se gjendja faktike i përgjigjet ndonjë shkelje tjetër disiplinore.

4. Në rast se faktet dhe provat e shqyrtuara nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar përgjegjësinë disiplinore të inxhinierit, Komisioni Disiplinor merr vendim të arsyetuar për lirim nga përgjegjësia disiplinore e inxhinierit.

5. Nëse masa disiplinore vendoset ndaj inxhinierit që ushtron veprimtarinë në Kosovë në bazë të njohjes së licencës të lëshuar jashtë Republikës së Kosovës, Oda sipas detyrës zyrtare njofton autoritetet përkatëse të shtetit të huaj për vendimin.

Neni 15

Masat disiplinore

1. Për shkelje të lehta disiplinore siç përcaktohen me këtë Rregullore, Komisioni Disiplinor shqipton masat disiplinore në vijim:

1.1. Vërejtje;

- 1.2. Gjoka në të holla e cila nuk mund të jetë më e ulët se tridhjetë (30) euro dhe më e lartë se pesëqind (500) euro.
2. Për shkelje të rënda disiplinore siç përcaktohen me këtë Rregullore, Komisioni Disiplinor shqipton masat disiplinore në vijim:
 - 2.1. Gjoka në të holla e cila nuk mund të jetë më e ulët se pesëqindnjë (501) euro dhe më e lartë se dy mijë (2000) euro;
 - 2.2. pezullimin e licencës në kohëzgjatje nga një (1) muaj deri në një (1) vit.
3. Me rastin e shqiptimit të masave disiplinore merren për bazë të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në llojin e masave dhe atë posaçërisht pesha dhe pasojat e shkeljes, dëmi i shkaktuar, shkalla e përgjegjësisë dhe masat e mëhershme disiplinore.

Neni 16

E drejta e ankesës dhe efekti pezullues i saj

1. Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor, inxhinieri i licencuar ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore, mund të paraqet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
2. Paraqitja e ankesës sipas këtij neni pezullon zbatimin e vendimit të Komisionit Disiplinor, deri në zgjidhjen e ankesës.

Neni 17

Procedura e shqyrtimit të ankesës

1. Ankesa shqyrtohet në afat prej tridhjetë (30) ditë nga paraqitja e saj. Ky afat është kumulativ dhe zbatohet për procedurën e shqyrtimit nga Komisioni Disiplinor dhe nga Komisioni i Ankesave, në përputhje me paragrafët vijues.
2. Ankesa shqyrtohet së pari nga Komisioni Disiplinor.
3. Në rast se vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, Komisioni Disiplinor anulon vendimin paraprak në tërësi dhe masën disiplinore të shqiptuar.
4. Në rast se vlerëson se ankesa nuk është plotësisht e pranueshme dhe e bazuar, Komisioni Disiplinor pa vonesë dhe më së largu brenda pesë (5) ditëve përcjellë ankesën tek Komisioni i Ankesave.

5. Komisioni i Ankesave mund të kryej shqyrtime administrative shtesë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, apo do të urdhëroj Komisionin Disiplinor që të zhvillojë shqyrtime të tilla dhe të njoftojë për to, mirëpo nuk mund të kthej lëndën në rishqyrtim dhe vendosje të Komisionit Disiplinor.
6. Në rast se vlerëson se ankesa është e papranueshme ose e pa bazuar, Komisioni i Ankesave e refuzon atë dhe vërteton vendimin e Komisionit Disiplinor.
7. Në të kundërtën nga paragrafi 6, Komisioni i Ankesave aprovon ankesën dhe:
 - 7.1. ndryshon vendimin e Komisionit Disiplinor duke ndryshuar masën disiplinore apo lartësinë e vet në rastin e gjobës;
 - 7.2. ndryshon apo plotëson vetëm arsyetimin e vendimit të Komisionit Disiplinor, atëherë kur vlerëson se dispozitivi i vendimit është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë Komisioni Disiplinor, apo vlerëson se arsyetimi nuk ka qenë i plotë;
 - 7.3. anulon vendimin dhe në tërësi masën disiplinore të shqiptuar nga Komisioni Disiplinor.
8. Ankesa e paraqitur nuk mund të përkeqësoj situatën juridike në dëm të inxhinierit të licencuar që ka paraqitur ankesë.
9. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar dhe ndaj këtij vendimi mund të ngritët padi për fillimin e konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

KAPITULLI IV

Neni 18

Evidentimi i masës disiplinore dhe fshirja nga dosja

1. Çdo masë disiplinore e shqiptuar evidentohet në dosjen e inxhinierit apo anëtarit tjetër të Odës ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore.
2. Masa disiplinore e shqiptuar ndaj inxhinierit të licencuar fshihet nga dosja e inxhinierit apo anëtarit të Odës, pas kalimit të këtyre afateve:
 - 2.1. Gjashtë (6) muaj pas shqiptimit të masës disiplinore të vërejtjes;
 - 2.2. Një (1) vit pas shqiptimit të masës disiplinore të gjobës për shkelje të lehtë disiplinore;

2.3. Tre (3) vite pas shqiptimit të masës disiplinore të gjobës për shkelje të rëndë disiplinore;

2.4. Pesë (5) vite pas shqiptimit të masës disiplinore të pezullimit të licencës.


3. Fshirja e masës disiplinore nga dosja bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të Drejtorit Ekzekutiv të Odës.

KAPITULLI V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca



Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës